



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **10**

Prishtinë, më 1.4.2015, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Emilija Redzeqi, Haxhi Shala, Adem Salihaj, Shaip Muja, Salih Salihu, Murat Hoxha.

Mungoi : Velimir Rakiq dhe Lahi Brahimaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë : sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi, Dalina Kërqeli.

Mbledhjen e kryesoi **Fikrim Damka**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 17.3.2015,
3. Shqyrtimi i çështjes së importit të grurit, me Ministrin e Bujqësisë dhe Sekretarin e Qeverisë,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.3.2015

Kryetari i Komisionit konstatoi miratimin e komisionit për procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

3. Shqyrtimi i çështjes së importit të grurit, me Ministrin e Bujqësisë dhe Sekretarin e Qeverisë

Kryetari përshëndeti të pranishmit dhe konstatoi se ministri ka lajmëruar mosardhjen për shkak të obligimit të paplanifikuar si dhe me arsyetim se MB nuk është pjesë e përgjegjëseve institucionale rreth cilësisë së ushqimit dhe importit, ndërkaq për akreditimin e IBK ka premtuar ministri se MB do të angazhohet rreth ndihmës së procesit të filluar të akreditimit për të përmbyllur me sukses. Kryetari më tutje potencoi se ky komision do të vazhdoi edhe një kohë të përmbylli analizat e filluara, ndoshta edhe me dalje në teren, në mënyrë që në fund të javës së ardhshme të propozohen rekomandimet për seancën plenare.

Salih Salihu shprehu habinë rreth mungesës së ministrit, ngase ky komision ka deshtë që përmes ministrit dhe ZKM të vërtetoi rrethanat që çojnë në konkluzë përfundimtare rreth çështjes së miellit, sidomos kur dihet fakti që nga ZKM ka pasur iniciativë për formimin e komisionit profesional rreth çështjes në fjalë, megjithatë ai shtoi se GP ka grumbulluar faktet e duhura për të përfunduar me rekomandime këtë çështje, përkundër faktit që gjatë analizave dhe vizitave ka pasur mjaft shpërputhje argumentesh. **Adem Salihaj** arsyetoi diskutimin e anëtarit të GP dhe shtoi se komisioni përmes ftesës për MB dhe ZKM është përpjek të shoh se çka ka ndihmuar Qeveria-Kryeministria për kontrollin ndaj AUV dhe IKB dhe mund të themi se janë dalë shumë vërejtje serioze, por siç po shihet MB aspak nuk tregon seriozitet. Ai tha se komisioni gjithsesi do të përfundoi punën e vet duke rekomanduar.

Shaip Muja gjithashtu shprehu befasinë për reagimin e ministrit me mosardhje dhe tha se “në Republikën e Kosovës siç shihet ka nevojë për trajnime profesionale, kush çka ka për detyrë”. Derisa MB është përgjegjëse kryesore për cilësinë e ushqimit e cila bënë përgatitjet për ta marr AUV-në nën ombrellën e saj, në anën tjetër vjen përgjigja se MB nuk qenka përgjegjëse për cilësinë e ushqimit, dhe shtoi se kudo në Evropë këto agjenci janë të pavarura në ekzekutimin e politikës së politikbërësit (MB) të saj, dmth fundi është që Qeveria garanton cilësinë.

Murat Hoxha u bashkëngjiti rreth joseriozitetit të institucionit në fjalë, ngase kush është i licencuar duhet ta ndjej veten përgjegjëse, edhe pse nuk është i akredituar, kudo që të jetë një agjenci, ky fakt nuk ja zvogëlon përgjegjësinë, ngase produkti final duhet të jetë i mirë për atë vend. Për disa çështje financiare ky komision ose GP ka shkuar ndoshta më larg sesa duhet, por me rëndësi është të kemi ushqimin e mirë. Mori shembull shtetin e Suedisë ku agjencitë janë të pavarura financiarisht. **Shaip Muja** u bashkëngjiti prapë duke theksuar se kjo Qeveri (si politikbërës) nuk din rolin e vet duke mos marr përgjegjësinë që i takon, ndaj patjetër ky komision duhet ti ballafaqoi ministritë involvuese (MB, MMPH) për të arritur te ndonjë rezultat konkret.

Kryetari Fikrim Damka falënderoi dhe shprehu konstatimin fillestar, se komisioni me sukses do të përfundoi rekomandimet pas konsultimeve që duhet të zhvillohen si në GP ashtu edhe në Komision.

4. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme **Kryetari** sugjeroi komisionin që të vendoset për një kandidat rreth kryesuesit të komisionit shqyrtues, pasi ligji nuk ka pengesa në këtë drejtim si dhe **Shaip Muja** propozoi për mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MMPH rreth ndotjes së mjedisit në rajonin e Drenasit, ndaj komisioni vendosi:

- **I rekomandohet seancës plenare Sabrije Abazi për Kryesues të Komisionit Shqyrtues në ZRRUK, dhe**
- **Caktohet mbledhja e komisionit për 7 prill ku do të ftohet Ministri i Mjedisit rreth ndotjes së mjedisit në rajonin e Drenasit, duke dërguar materialin e propozuar nga deputeti Shaip Muja.**

Mbledhja përfundoi në orën 14,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Fikrim Damka